



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site:www.klsh.org.al

Nr. 1026/17 Prot.

Tiranë, më, 31/12/2017

V E N D I M

Nr. 214, Datë 31/12/2017

**PËR
AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË INSTITUCIONIN
"BASHKIA TIRANË-ISH 4 KOMUNAT: KASHAR, SHËNGJERGJ, KRRABË DHE
ZALL-BASTAR"**

Opinion i kualifikuar

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer në subjektin Institucioni Bashkia Tiranë 4 ish komnat: Kashar, Shëngjergj, Krrabë dhe Zall-Bastar", mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

Baza për opinion të kualifikuar

Nga auditimi u konstatua se pasuritë e 4 ish komunave Kashar, Shëngjergj, Krrabë, Zall-Bastar "Toka, Troje, Terene" nuk janë regjistruar në ZRPP Tiranë dhe si rrjedhim edhe në bilancin e njësive vendore. Llogaria 202 "Studime e projekte" e aktivitetit të bilancit të ish Komunave Kashar, Shëngjergj e Zall-Bastar, mbart ende vlerën 140,416 mijë lekë të projekteve dhe studimeve të financuara në vite edhe pse veprat kanë përfunduar së ndërtuari, mangësi të cilat bëjnë që pasqyrat financiare të mos pasqyrojnë drejt dhe sakt vlerën e aktiveve të njësive vendore. Në asnjë nga 4 njësitë vendore nuk është hartuar regjistri kontabël i aseteve. Gjithashtu nuk është hartuar regjistër për pronat e dhëna me qira dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësit në vlerën 2,704,590 lekë.

Në fushën e prokurimit publik, u konstatuan devijimeve nga rregullat e prokurimit publik dhe praktika jo në përputhshmëri me kërkesat ligjore, duke kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e dokumenteve standarde të tenderit, me pasojë

përdorim të fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në 9 procedura prokurimi, në vlerën 57,360 mijë lekë, të cilat kanë dhënë efekt negativ në buxhetin e njësisve vendore. Në një rast janë shkelur dukshëm afatet kontraktuale të zbatimit të punimeve dhe nuk janë zbatuar kërkesat ligjore për aplikimin e penalteteve nga sipërmarrësi në vlerën 3,180,294 lekë. Për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV nuk janë ndjekur procedurat ligjore, pasi 68% e tyre rezultojnë të pa arkëtuara ose në vlerën 2,000,000 lekë.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të “Auditimit të përputhshmërisë, të ushtruar në institucionin “Bashkia Tiranë-ish 4 komunitat: Kashar, Shëngjergj, Krrabë dhe Zall-Bastar”, sipas programit të auditimit nr.1026/1 prot, datë 10.10.2017, për veprimtarinë nga data 01.01.2013 deri më 31.07.2015 për ish Komunën Shëngjergj, Krrabë, Zall-Bastar dhe periudhën 01.07.2014 deri më 31.07.2015 për ish Komunën Kashar.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pasuritë e 4 ish komunave Kashar, Shëngjergj, Krrabë, Zall-Bastar “Toka, Troje, Terene” nuk janë regjistruar në ZRPP Tiranë dhe si rrjedhim edhe në bilancin e njësisve vendore. Llogaria 202 “*Studime e projekte*” e aktivitetit të bilancit të 4 ish komunave Kashar, Shëngjergj, Krrabë, Zall-Bastar, mbart ende vlerën 140,416 mijë lekë të projekteve dhe studimeve të financuara në vite edhe pse veprat kanë përfunduar së ndërtuari, mangësi të cilat bëjnë që pasqyrat financiare të mos pasqyrojnë drejt dhe saktë vlerën e aktiveve të njësisve vendore.

1.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë të marrë masa për rregjistrimin në ZRPP të të gjitha pronave të ish komunave e të bëjë pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerën e indeksuar të zonës kadastrale. Të analizohet dhe sistemohet llogaria 202 “*Studime e projekte*” e ish komunave bazuar në investimet e objekteve të përfunduara dhe vlerën e projekteve të tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Shëngjergj, në dy raste në vitin 2013, janë blerë 2 projekte, përkatësisht “Hartim projekti të vlerësimit mjedisor të zhvillimit urban”, në vlerën 148,000 lekë dhe “Sistem informacioni GIS për planin rregullues të Komunës Shëngjergj”, në vlerën 480,000 lekë. Projektet edhe pse janë fizikisht, pasi u paraqitën pranë grupit të auditimit, nuk janë bërë hyrje, nuk janë kontabilizuar në llogarinë e aktiveve të ish komunës, dhe për rrjedhojë nuk janë në të regjistruar në inventarët e Njesisë Administrative Shëngjergj dhe Bashkisë Tiranë.

2.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë të marrë masa për pasqyrimin në kontabilitetin e Njesisë Administrative Shëngjergj të dy projekteve, aktive të pa trupëzuara: “Hartim projekti të vlerësimit mjedisor të zhvillimit urban”, në vlerën 148,000 lekë dhe “Sistem informacioni GIS për planin rregullues të Komunës Shëngjergj” në vlerën 480,000 lekë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në të 4 ish-komunat Kashar, Shëngjergj, Krrabë, Zall-Bastar, nuk është krijuar regjistri kontabël i asetëve që zotëron secila njësi vendore, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga ish-Komuna Kashar, në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira, ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit *kalendarik*.

3.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Asetëve dhe Licensimit dhe Njësive Administrative Kashar, Krrabë, Shëngjergj dhe Zall Bastar pas azhurnimit të asetëve të kaluara në pronësi ish-komunave dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Tiranë në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e truall të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga 4 ish komunitat Kashar, Krrabë, Shëngjergj dhe Zall-Bastar, u konstatua se lista e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të hartuara prej tyre në mbyllje të aktivitetit të njësisë vendore për shkak të reformës administrativo-territoriale, nuk janë pasqyruar në DPTTV të Bashkisë Tiranë dhe për rrjedhojë nuk është ndjekur procesi i kryerjes së pagesë prej tyre. Konkretisht këto vlera dhe numri i subjekteve sipas ish komunave janë: ish komunën Kashar vlera 295,661,501 lekë e përbërë nga 2,384 subjekte, ish Komuna Krrabë, vlera 3,741,125 lekë përbërë nga 155 subjekte; ish Komunën Shëngjergj, vlera 1,187,745 lekë, e përbërë nga 31 subjekte; ish Komunën Zall-Bastar, vlera 130,100 lekë, e përbërë nga 7 subjekte.

4.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për pasqyrimin e subjekteve debitorë sipas listës së hartuar nga ish komunitat në mbyllje të aktivitetit të tyre për shkak të reformës administrativo-territoriale, si dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave përkatëse ende të pa arkëtuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 15 dosjeve të lejeve zhvillimore të miratuara nga ish-Komuna Kashar, u konstatuan mangësi të dokumentacionit plotësues, si mungesë e dokumenteve të caktuara e dokumentacioni pa noterizuar, në pajtueshmëri me ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

5.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Njësine Administrative Kashar, të marrë masa që në rastet kur subjektet të aplikojnë për certifikatë përdorimi, t’ju kërkojnë subjekteve edhe plotësimin e mangësive të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe më pas të lëshojnë certifikatën e përdorimit, në zbatim të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e

Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të lejeve zhvillimore të miratuara nga ish-Komuna Shëngjergj, për lejen zhvillimore në favor të “A”, administrohet vetëm kontrata e qirasë midis zhvilluesit dhe Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë, por mungon dokumentacioni i pronësisë për lejen zhvillimore të miratuar, në pajtueshmëri me ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

6.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë në bashkërendim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Njësinë Administrative Shëngjergj, të marrë masa dhe të rivlerësoj lejen zhvillimore të miratuar nga ish-komuna Shëngjergj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

Brenda muajit Qershor 2018

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2015 Komuna Kashar është audituar sipas programit të auditimit nr. 591/2 prot., datë 12.06.20014 të KLSH, për periudhën 01.07.2011-31.07.2014. KLSH me shkresën nr. 591/11 prot., datë 24.09.2014, ka dërguar në Komunën Kashar “Raportin përfundimtar dhe rekomandimet”.

Nga 8 masa për shpërblim dëmi në vlerën 15,090,868 lekë, janë zbatuar tre prej tyre në vlerën 1,986,592 lekë, në proces gjyqësor vlera 1,984,590 lekë, pa arkëtuar ende vlera 10,847,838 lekë, ose 72% e vlerës së rekomanduar. Nga vlera e pa arkëtuar është falur me vendim të këshillit të komunës vlera 5,823,783 lekë, tejkalim kompetencash nga ana e këshillit, pasi nuk mund të falë vlera financiare të cilat rrjedhin nga detyrime ligjore kontraktuale.

7.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, ende të pa zbatuara nga ish Komuna Kashar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2015 janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve për çdo muaj në mungesë të list-prezencave të pjesëmarrjes së këshilltarëve në mbledhje, si dhe pa bërë verifikim nëse këshilltarët kanë qenë pjesëmarrës në mbledhjet e këshillit. Grupi i auditimit gjykon se pagesat nga zyra e financës janë realizuar pa dokumentacionin e nevojshëm vërtetues, list-prezencën dhe protokollin e mbledhjeve. Me dokumentacionin jo të plotë të paraqitur, u konstatua një vlerë prej **2,019,133 lekë, për tre ish komunat** Kashar, Krrabë e Zall-Bastar, të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e këshillit të komunës, si dhe janë shpërblyer edhe për muaj në të cilët nuk janë zhvilluar mbledhjet të këshillit, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **2,019,133 lekë** pagesë për këshilltarët, për të cilën dokumentacioni vërtetues nuk është i saktë. Në mungesë të dokumentacionit të plotë, vlera e mësipërme nuk jep besueshmëri dhe për këtë arsye grupi i auditimit nuk jep siguri të arsyeshme përse i përket rregullshmërisë ligjore të ndjekur nga njësitë vendore, në pagesën e këshilltarëve për tre ish komunat.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2; neni 31, pika 2 dhe pika 8.

8.1. Rekomandim: Në kushtet e pamundësisë nga KLSH të verifikimit rast pas rasti të dokumentacionit dhe protokolleve të mbledhjeve për pagesat e këshilltarëve të **tre ish komunave:** Kashar, Krrabë e Zall-Bastar, mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, -Të

drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, sipas të cilit “KLSH ka të drejtë të propozojë njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencës të tyre” ; nenit 25-Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe ISSAI 1600, rekomandojmë: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tiranë, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve. Pas verifikimit dhe saktësimit të këtyre pagesave, **i lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në 5 investimet e audituara me vlerë totale të kontratave **37,406,322 lekë pa TVSH**, nga verifikimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike, si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **520,496 lekë pa TVSH**, mos aplikim i penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve në vlerën **3,180,294 lekë** si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9 dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4, paragrafi 4.

9.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tiranë, të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, pika, 4 paragrafi 4.

Në vazhdimësi

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njesisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **11,095,297 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim KUZ dhe Sistemim i Rrugës së Lagjes Hysaj, Fshati Shemri”, ish-Komuna Shëngjergj, Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, në vlerën **46,500 lekë pa TVSH**, si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **3,180,294 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 155 prot., datë 29.03.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Shëngjergj dhe OE “**B...**” Shpk.

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **46,500 lekë** pa TVSH nga OE “**B...**” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 155 prot., datë 29.03.2013 me objekt “Ndërtim KUZ dhe Sistemim i Rrugës së Lagjes Hysaj, Fshati Shemri”, ish-Komuna Shëngjergj, Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

1.2. Rekomandim: Nga Bashkia Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,180,294 lekë** nga OE “**B...**” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 155 prot., datë 29.03.2013 me objekt “Ndërtim KUZ dhe Sistemim i Rrugës së Lagjes Hysaj, Fshati Shemri”, ish-Komuna Shëngjergj, Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Shëngjergj ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Kashar për periudhën 01.07.2014-31.07.2015 janë lidhur 26 kontrata qiraje banese (ish-godinë) për qëllime strehimi të shtresave në nevojë. konstatohet se detyrimet kontraktuale të qirasë për 26 kontratat nuk janë paguar nga qiramarrësit, duke i shkaktuar buxhetit të ish-komunës Kashar **dëm ekonomik në vlerën totale 2,704,590 lekë**.

2.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, të kontabilizojë detyrimin dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **2,704,590 lekë** nga qiramarrësit bazuar në kontratat e qirasë dhe listën e debitorëve të lënë nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunës Kashar sektori i IMTV për periudhën 01.07.2014-31.07.2015, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, VKM nr.862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar, ka marrë 27 vendime për dënim me gjobë në vlerën totale 2,920,000 lekë, nga të cilat rezultojnë të paarkëtuara 19 gjoba, duke i shkaktuar buxhetit të ish-komunës Kashar **dëm ekonomik në vlerën 2,000,000 lekë**.

3.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, mbështetur në aktet e vendosjes së gjobës nga IMTV Kashar, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **2,000,000 lekë nga 19 subjektet** të cilat nuk kanë kryer pagesën e gjobës, sipas listës së lënë nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Nga strukturat përkatëse të krijuhet regjistri elektronik i debitorëve dhe të bëhet regjistrimi i detyrimit të mësipërm në kontabilitet.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Ndërtim i shkollës fillore në fshatin Shëngjin”, ish Komuna Shëngjergj, me fond limit 3,667,785 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.09.2013, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “**E.-V.**”&“**H.**” sh.p.k., me vlerë të ofertës ekonomike 3,546,872 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e DST dhe, ka s’kualifikuar

padrejtësisht BOE “E.”&“A. L. I.” sh.p.k. me vlerë të ofertës ekonomike 2,842,833 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 704,039 lekë**, si diferencë midis dy ofertave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, pika b, d, dh; nenin 2, pika a, c; nenin 53 pika 3; 5; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

4.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **704,039 lekë** nga personat e mëposhtëm:

1. **Z. B. H.** në cilësinë e anëtarit të KVO, **për vlerën 234,680 lekë**

2. **Z. K. M.** në cilësinë e anëtarit të KVO, **për vlerën 234,680 lekë**

3. **Z. B. C.** në cilësinë e anëtarit të KVO, **për vlerën 234,680 lekë**

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Shëngjergj, me urdhër shpenzimin nr. 30, datë 13.03.2013, është likuiduar vlera 480,000 lekë, me përfitues operatori ekonomik “Gj” sh.a., për objektin e prokurimit “Zhblllokim nga bora i rrugëve të Komunës Shëngjergj”, zhvilluar sipas urdhrat të prokurimit nr.41, datë 23.11.2012. Nuk vërtetohet me dokumentacion shërbimi dhe puna e kryer nga operatori ekonomik, pasi nuk ka situacione ditore dhe situacione të tjera periodike (javore, mujore etj.), që të vërtetojë datën kur rrugët janë bllokuar nga bora dhe orët e punës që ka punuar mjeti për secilën datë (kontrata është lidhur me çmimin bazë 4,000 lekë/ora). Për këtë arsye procesverbali dhe situacioni të hartuar në fund të përfundimit të kontratës 3 mujore, janë fiktivë, pasi nuk mbështeten nga dokumentacioni periodik i mësipërm. Vlera **480,000 lekë konsiderohet dëm ekonomik** shkaktuar buxhetit të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,37, 38,42, 43, 52,54, ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4, pika 18, 19, neni 8, 9, 12. Për arsye se nuk vërtetohet me dokumentacion pastrimi i rrugëve të komunës nga bora.

5.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **480,000 lekë nga shoqëria “Gj. K.” sh.a.**, e cila ka përfituar padrejtësisht vlerën e mësipërme, pasi nuk vërtetohet me dokumentacion shërbimi i pastrimit të rrugëve të Komunës Shëngjergj nga bora.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim Kanalizime të Ujërave të Zeza Rruga At Zef Pëllumbi-Stacioni Elektrik”, ish-Komuna Kashar, me fond limit 2,613,020 lekë, zhvilluar në datën 26.12.2014, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, duke i shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 236,710 lekë pa TVSH për punime të pakryera**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Kashar, Tiranë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. F.V, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

6.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **236,710 lekë pa tvsh** nga OE “K.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën, me objekt “Ndërtim Kanalizime të Ujërave të Zeza Rruga At Zef Pëllumbi-Stacioni Elektrik”, datë 04.03.2015 ish-

Komuna Kashar, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Ndërtim KUZ dhe sistemim i rrugës së lagjes Hysaj, fshati Shëmri*”, me fond limit 7,225,177 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.02.2013, ish Komuna Shëngjergj, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “**B.**” **sh.p.k** me vlerë të ofertës ekonomike 6,999,523 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e DST dhe, ka s’kualifikuar padrejtësisht OE “**L.**” **sh.a.** me vlerë të ofertës ekonomike 6,641,742 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 357,781 lekë**, si diferencë midis dy ofertave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, pika b, d, dh; nenin 2, pika a, c; nenin 53 pika 3; 5; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Tiranë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **357,781 lekë** nga personat e mëposhtëm:

1. **Z. B. H.** në cilësinë e anëtarit të KVO, **për vlerën 119,260 lekë**

2. **Z.K. M.** në cilësinë e anëtarit të KVO, **për vlerën 119,260 lekë**

3. **Z.B. C.** në cilësinë e anëtarit të KVO, **për vlerën 119,260 lekë**

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Shëngjergj, me urdhër shpenzimin nr.5, datë 16.01.2014, është likuiduar vlera 395,000 lekë për 15 persona, për “*Udhëtim turistik 3 ditor jashtë vendit, të këshilltarëve të komunës*”. Për këtë udhëtim nuk ka program pune për aktivitete ndërkombëtare, si konferenca, marrëveshje, takime pune, trajnime etj.; personat pjesëmarrës nuk janë punonjës organik të njësisë vendore, por këshilltarë, të cilët nuk janë pjesë e strukturës së komunës. Gjithashtu nuk ka dokumentacion vërtetues për të argumentuar shpenzimet e transportit (bileta), të fjetjes (fatura hoteli) dhe pagesat e tjera të ushqimit (fatura). Vlera **395,000 lekë konsiderohet dëm ekonomik** shkaktuar buxhetit të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën nr.1, nr.11 të VKM nr.870, datë 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*”.

8.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **395,000 lekë** nga 15 personat pjesëmarrës në udhëtimin turistik, sipas listës së lënë nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim Linje Rezervë për Furnizimin me Ujë të Depove 200 m³, Mëzez dhe 400 m³Yrshëk*”, ish-Komuna Kashar, Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në vlerën **298,800 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 539/5 prot., datë 07.05.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Kashar dhe OE “*K*” ShPK.

9.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tiranë, për ish-Komunën Kashar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **298,800 lekë pa TVSH** nga OE “**K.**” **sh.p.k.** në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 539/5 prot., datë 07.05.2015 me objekt “*Ndërtim Linje Rezervë për Furnizimin me Ujë të Depove 200 m³, Mëzez dhe 400 m³Yrshëk*”, ish-Komuna Kashar, Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën janar 2013-qershor 2015 në ish Komunën Shëngjergj janë bërë pagesa për kompensim të shpenzimeve të impulseve të telefonisë celulare për ish kryetarin e komunës z. **D. D.** në vlerën totale 222,387 lekë. Ish kryetari i komunës ka përfituar padrejtësisht vlerën e mësipërme, në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr.864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 222,387 lekë.**

10.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e vlerës **222,387 lekë nga z. D. D.** me detyrë ish kryetar i Komunës Shëngjergj.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga IMT e ish-Komunës Krrabë për periudhën objekt auditimi gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr.862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar, u konstatua se ka marrë 1 vendim për dënim me gjobë në vlerën 200,000 lekë, e cila rezulton e paarkëtuar, duke i shkaktuar buxhetit të ish-komunës Krrabë **dëm ekonomik në vlerën 200,000 lekë.**

11.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, mbështetur në aktin e vendosjes së gjobës nga IMTV Krrabë, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **200,000 lekë.** Drejtoria ekonomike të marrë masa për regjistrimin si detyrim në kontabilitet të kësaj vlere, si dhe të krijohet regjistri elektronik i debitorëve.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Krrabë me urdhër shpenzimin nr.66, datë 23.05.2013 është likuiduar vlera 94,400 lekë për operatorin ekonomik “**F**” **sh.p.k.** për objektin e prokurimit “Shërbim i pastrimit të mbetjeve urbane në Komunën Krrabë”, sipas shtesës së kontratës nr.422/2 prot., datë 31.12.2012, dhe urdhrin të prokurimit nr.47, datë 31.12.2012. Kryerja e shërbimit të pastrimit nuk argumentohet me dokumente vërtetuese, pasi nuk ka dokumentacion për kryerjen e supervizimit të shërbimit, për kontrollin dhe matjen e shërbimit të kryer, nuk janë hartuar situacione ditore, mujore dhe as situacioni përfundimtar. **Vlera prej 94,000 lekë, konsiderohet dëm ekonomik** shkaktuar buxhetit të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35, 37, 38,42, 43, 52,54, ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4, pika 18, 19, neni 8, 9, 12.

12.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **94,000 lekë, nga operatori ekonomik “F.” sh.p.k.**

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim i Shkollës Filllore në Fshatin Shëngjin*”, ish-Komuna Shëngjergj, Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pa kryera në vlerën **72,286 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 479 prot., datë 10.10.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Shëngjergj dhe BOE “*E.-V.*” **sh.p.k.** dhe “*H.*” **sh.p.k.**

13.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tiranë, për ish Komunën Shëngjergj, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **72,286 lekë pa TVSH** nga operatorët ekonomikë “*E.-V.*” **sh.p.k.** dhe “*H.*” **sh.p.k.** në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 479 prot., datë 10.10.2013 me objekt “*Ndërtim i Shkollës Filllore në Fshatin Shëngjin*”, ish-Komuna Shëngjergj, vlerë kjo e cila

përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Vazhdim Punimesh për Ndërtimin e Korsive Paralele të Rrugëve Marie Kraja*”, ish-Komuna Kashar, Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por tw pakryera në vlerën **64,560 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 533/5 prot., datë 17.06.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Kashar dhe BOE “**K.**” sh.p.k. & “**K. K.**” sh.p.k.

14.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tiranë, për ish Komunën Kashar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **64,560 lekë pa t.v.sh** nga BOE “**K**” sh.p.k. & “**K. K.**” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 533/5 prot., datë 17.06.2015 me objekt “*Vazhdim Punimesh për Ndërtimin e Korsive Paralele të Rrugëve Marie Kraja*”, ish-Komuna Kashar, Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim Kanalizime të Ujërave të Zeza Rruga At Zef Pëllumbi – Stacioni Elektrik*”, ish-Komuna Kashar, Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por pakryera në vlerën **38,350 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 04.03.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Kashar dhe OE “**K**” sh.p.k.

15.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tiranë, për ish – Komunën Kashar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **38,350 lekë pa TVSH** nga operatorët ekonomikë “**K**” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 04.03.2015 me objekt “*Ndërtim Kanalizime të Ujërave të Zeza Rruga At Zef Pëllumbi – Stacioni Elektrik*”, ish-Komuna Kashar, Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

B2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Për shkak të kryerjes së shpenzime për kontrole e shërbime periodike të paargumentuara për mjetet e transportit, për mos zbatimin në kohë të një vendimi të formës së prerë të Gjykatës së Tiranë dhe si rezultat i mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, duke kualifikuar operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, janë përdorur fonde publike **në kundërshtim me kërkesat ligjore në masën 59,833 mijë lekë, të cilat kanë dhënë efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore**, prej të cilave vlera 57,360 mijë lekë në fushën e prokurimit publik.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të zhvilluara, u konstatuan se 9 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e

përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Nga këto 4 raste në ish Komunën Kashar në vlerën 38,884 mijë lekë; 2 raste në ish Komunën Zall-Bastar në vlerën 13,755 mijë lekë; 2 raste në ish komunën Shëngjergj në vlerën 3,889 mijë lekë; 1 rast në ish komunën Krrabë në vlerën 831 mijë lekë.

Operatorët ekonomik janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Autoritetit Kontraktor, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të kushteve të kontratës në këto tendera, për shkak të mos përmbushjes së kriteretve të vendosura në DST. Në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

1.-Gjetje nga auditimi, 1.a: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Mirëmbajtje objekte arsimore dhe shëndetësore*”, (ish-Komuna Kashar), me fond limit 12,500,000 lekë, zhvilluar në vitin 2014, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “**Sh.**” **sh.p.k.** i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës ekonomike 10,259,349 lekë. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 10,259,349 lekë.**

1.b: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Mirëmbajtje objekte arsimore dhe shëndetësore*”, (ish-Komuna Kashar), me fond limit 12,500,000 lekë, zhvilluar në vitin 2015, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “**Sh.**” **shpk & “D.” shpk**, i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës ekonomike 9,644,136 lekë. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 9,644,136 lekë .**

1.c: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Vazhdim punimesh për korsitë paralele rruga Faik Konica*”, (ish-Komuna Kashar), me fond limit 17,664,647 lekë, zhvilluar në vitin 2015, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “**L.**” **sh.a & “Sh.” sh.p.k.**, me vlerë të ofertës ekonomike 13,755,070 lekë, i cili nuk plotëson kërkesat e DST. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 13,755,070 lekë.**

1.d: Në tenderin me objekt “*Ndërtim këmbë ure Bejli në lumin Pjec fshati Mner i Sipërm*”, me fond limit 5,314,873 lekë, zhvilluar në datën 13.07.2013, ish Komuna Zall-Bastar, është kualifikuar dhe shpallur fitues BO “**E.**” & “**F.**”, i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës 5,225,705 lekë. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 5,225,705 lekë.**

1.e: Në tenderin me objekt “*Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Murrizë*” me fond limit 12,498,964 lekë, zhvilluar në datën 5.6.2013, ish Komuna Zall-Bastar, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “**R.**”& “**L.**” **sh.p.k.**, i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës 12,489,365 lekë. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 12,489,365 lekë.**

1.f: Në tenderin me objekt “*Blerje dru zjarri*” me fond limit 1,266,667 lekë, zhvilluar në datën 26.4.2013, ish Komuna Zall-Bastar, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “**R.**” **sh.p.k.** i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës ekonomike 1,266,000 lekë. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk

plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 1,266,000 lekë.**

1.g: Në tenderin me objekt “*Rikonstruksion i rrugëve rurale në Komunën Shëngjergj*”, me fond limit 1,525,107 lekë, zhvilluar në datën 23.4.2013, ish Komuna Shëngjergj, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “**Gj. K.**” sh.a. i cili nuk plotëson kriteret e DST, me vlerë të ofertës ekonomike 1,513,325 lekë. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 1,513,325.**

1.h: Në tenderin me objekt “*Sistemim i rrugës Lagjja Lilaj Kodra Dangës në fshatin Shemri*” 23.6.2014, ish Komuna Shëngjergj, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “**Gj. K.**” sh.a. i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës ekonomike 2,376,393 lekë. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 2,376,393 lekë.**

1.i: Në tenderin me objekt “*Grumbullimi dhe pastrimi i mbetjeve urbane në Komunën Krrabë*”, me fond limit 835,920 lekë, zhvilluar në datën 23.6.2014, ish Komuna Krrabë, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “**F.**” sh.p.k. i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës ekonomike 831,276 lekë. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 831,276 lekë.**

1.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë nëpërmjet strukturave përkatëse të kryerjes së procedurave të prokurimit publik, të konsiderojë faktin se kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, shkakton **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, pa economicitet eficient dhe efektivitet**, për shkak se në këto raste operatorët ekonomik nuk garantojnë realizimin me cilësi të kontratës.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Kashar, në një rast nuk është zbatuar në kohë vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1234, datë 05.06.2013, lidhur me pagesën e detyrimit për subjektin “**E.**” sh.p.k. Paga është kryer me urdhër shpenzimit nr.238, datë 29.07.2014, ose 419 ditë me vonesë, për të cilat janë paguar interesa në vlerën 1,131,225 lekë, me pasojë **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore në vlerën 1,131,225 lekë.**

2.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, në rastet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatës, përpara zbatimit të tyre, të analizojë këto vendime, të nxjerrë përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi. Paga e vendimeve të bëhet në kohë, me qëllim shmangien e interesave bankare dhe rritjen e detyrimit të pagesës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Kashar, për periudhën 14 mujore, maj 2014-qershor 2015 janë bërë 12 kontrolle e shërbime teknike mujore të njëpasnjëshme për të njëjtat mjete, kontrolle të paracaktuara në kontrata të vitit paraardhës dhe jo si rezultat i verifikimit konkret të gjendjes teknike të mjetit, pa u argumentuar nevoja e mjeteve për kontrolle e shërbime, **me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën 1,341,170 lekë.** Kontrollat e shërbimeve të kryera në vitin 2014 janë kryer mbi bazën e prokurimit të kryer në vitin 2013 dhe ato të vitit 2015 mbi bazën e prokurimit të vitit 2014, duke shkelur rregullat e prokurimit publik, në kundërshtim me kreun VII, pika 3, germë a, “Kohëzgjatja e kontratës”, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar ku thuhet se “Autoriteti Kontraktor prokuron dhe financon kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit ushtrimor”.

3.1. Rekomandim: Bashkia Tiranë, të marrë në konsideratë shkeljet e konstatuara në ish komunën Kashar për riparimin e automjeteve, duke ndjekur praktika të cilat bëjnë të mundur që më parë të bëhet përcaktimi i defekteve e nevojave konkrete të mjetit në servis të licencuar dhe mbi bazën e certifikatës së lëshuar prej tij, të kryhen riparimet e nevojshme. Shpeshtësia për kryerjen e shërbimeve të zakonshme të mbështetet në sasinë e kilometrave të përshkruara, orëve të punës etj., sipas karakteristikave individuale të secilit mjet, të përcaktuara në certifikatat teknike të tyre. Në mënyrë që të eliminohen përsëritjet në kryerjen e shërbimeve të njëjta dhe nga operatori ekonomik të rritet përgjegjësia, prej tij të kërkohet garanci për shërbimin e kryer.

Në vazhdimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Tiranë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë, për 2 mbikëqyrës punimesh, si më poshtë:**

1.A. S. në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në një objekt “Ndërtim KUZ dhe Sistemim i Rrugës së Lagjes Hysaj, Fshati Shemri”, me sipërmarrës punimesh OE “**B.**” **sh.p.k** me pasojë dëm ekonomik në vlerën **3,226,794 lekë pa TVSH**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt si dhe prej mos marrjes së masave për aplikimin e penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve;

2.R. T. në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në njëobjekt “Ndërtim Linje Rezervë për Furnizimin me Ujë të Depove 200 m³, Mëzez dhe 400 m³ Yrshek”, me sipërmarrës punimesh OE “**B.**” **sh.p.k.** me pasojë dëm ekonomik në vlerën **298,800 lekë pa TVSH**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, si dhe prej mos marrjes së masave për aplikimin e penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve.

D. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë, që të analizojë dhe ndajë përgjegjësitë për të gjithë personat që bëhen me përgjegjësi nga ky auditim, mbështetur në vendim dhe raportin përfundimtar e mbi bazën e performancës së gjithsecilit të aplikoj dhënien e masave disiplinore.** Masat disiplinore për punonjësit të cilët janë me status të nëpunësit civil, të bazohen në nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, ndërsa për punonjësit me kontratë në nenet

37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në kontratës individuale të punës.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

- 1.**A.D.** me detyrë përgjegjësi i shërbimeve në ish Komunën Krrabë
- 2.**F.Ç.** me detyrë ish përgjegjës i financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues në ish Komunën Krrabë.
- 3.**F.H.** me detyrë ish specialist i pyjeve në ish komunën Krrabë, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 4.**P.LI.** me detyrë n/kryetar i komunës Kashar, në cilësinë e kryetarit të KVO.
- 5.**B.K.** me detyrë ish përgjegjës i financës në ish Komunën Kashar, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 6.**B.A.** me detyrë ish përgjegjës i shërbimeve në ish Komunën Kashar dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
7. **IA.** me detyrë ish specialiste e zyrës juridike në ish Komunën Kashar, në cilësinë e anëtares së NJP.
- 8.**M.Sh.** me detyrë ish specialiste në ish Komunën Kashar në cilësinë e anëtares së NJP.
9. **E.I.** me detyrë ish specialist në ish Komunën Kashar në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 10.**L.S.** me detyrë ish specialist i zyrës së shërbimeve në ish Komunën Kashar në cilësinë e anëtarit të NJP.
- 11.**H.Sh.** me detyrë ish përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave vendore, ish Komuna Kashar.
- 12.**D.H.** me detyrë ish përgjegjës i policisë së Komunës Kashar
- 13.**J.M.** me detyrë ish përgjegjës i zyrës së urbanistikës, ish Komuna Kashar.
- 14.**K.E.** me detyrë ish n/kryetar i Komunës Zall-Bastar, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 15.**Y.D.** me detyrë ish përgjegjës i shërbimeve në ish Komunën Shëngjergj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

BUJAR LESKAJ

K R Y E T A R